



Pranuar / Dërguar Punë/Prezantuar Received/Delivered	23.02.2023	Viti God Year	2023
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org / Unit	Dr Prot Dr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kohësira Quantity
SKIMSHUK	2032/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.133/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.133/2023 të datës 24.01.2023, të parashtruar nga ankuesja në çështjen juridike “Shkelje e të drejtës në pagë”, në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.133/2023 të datës 24.01.2023 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Lipjanit në pozitën “Nëpunëse Kadastrë”, më datë 20.01.2023 përmesë postës ka parashtruar ankesë e cila është regjistruar me datë 24.01.2023 me numër të protokollit 733/2023 të regjistruar nën shenjën A.nr.133/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës me titullin e pozitës dhe përshkrimin e vendit të punës nga koeficienti aktual pesë (5) në koeficientin e pagës gjashtë (6).

Kolegji i Këshillit duke marr parasysh se pretendimet ankimore të ankueses kanë për objekt çështjen e harmonizimit të koeficientit aktual të pagës, thekson faktin se më datë 05.02.2023 ka hyrë në fuqi Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ku si rrjedhojë me këtë ligj parashihen rregulla dhe kushte tjera për përcaktimin e pagës të të punësuarve në sektorin

publik, duke përfshi edhe koeficientet dhe nivelet e koeficienteve të pagës të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi aktual i pagave.

Për më tepër, me dispozitat kalimtare të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ndërsa me nenin 42 paragrafi 1 ndalohet çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve aktual të pagave.


Andaj, duke marr parasysh faktin se pas parashtrimit të ankesës nga pala ankuese kanë ndryshuar rrethanat ligjore dhe faktike mbi të cilat janë ngritur pretendimet ankimore, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti për të cilën ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur apo i kotë, ngase edhe nëse do të kishte vendimmarrje pozitive, për shkak të rrethanave të krijuara si pasojë e bazës së re ligjore, koeficienti i ndryshuar i pagës nuk mund të aplikohet në sistemin e ri të pagave, dhe rrjedhimisht konstaton se lidhur me këtë çështje ankimore janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 104 ku përcaktohet se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë.*

Përfundimi i këtij procedimi administrativ, palës ankuese nuk ia mohon të drejtën e parashtrimit të ankesës lidhur me koeficientin e pagës sipas sistemit të ri të pagave që rrjedh nga dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Kështu që duke u bazuar në dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi për përfundimin e procedimit administrativ, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda. A.nr.133/2023

Çlirim Zeka

Procesmbajtës


Eshref Shabani
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Lipjanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Lipjanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

